



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.571/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Shqipe Jashari kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për mungesë të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të pa rregullta ankesat e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Ferizajt, Shqipe Jashari nga subjekti politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me numër ZL.Anr.571/2017, ZL.Anr.572/2017, ZL.Anr.573/2017, ZL.Anr.574/2017, ZL.Anr.575/2017, ZL.Anr.576/2017, ZL.Anr.577/2017, ZL.Anr.578/2017, ZL.Anr.579/2017 dhe ZL.Anr.580/2017 të datës 09.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017, PZAP-i ka pranuar 10 (dhjetë) ankesa nga Shqipe Jashari, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga subjekti politik LVV, me të cilën thekson se në Qendrat e Votimit: 2508D/03D, 2507-01R, 25-33D në Prelez, 2519D-01R, 2505D-02R, 25-34D, 2519D-02D, 2537D-01, 2529D-01R, 2529D-02D, nuk ka asnjë votë por që dëshmitarët tregojnë të kundërtën. Më tej ka theksuar se për këto pretendime dëshmon Sylejman Shala.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.571/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesës, gjeti se:

Ankesat janë të pa rregullta

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesat e parashtruara nga ana e Shqipe Jashari, nga radhët e LVV-së, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, janë të parregullta, sepse nuk janë të nënshkruara nga Shqipe Jashari dhe si të tilla ankesat nuk i plotësojnë kriteret e

Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6, ku përcaktohet se: Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërsënuar e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.571/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.